



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 357 Prot.

Tiranë, më 21.05 2015

VENDIM Nr. 35 , datë 13.05.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), Neni 46, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, të datës 13.05.2015, pasi shqyrtoi *Relacionin mbi verifikimin në terren të gjetjeve arkeologjike rastësore në fshatin Dukaj-Tepelenë*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Gjirokastrë,

VENDOSI:

- I. Të kryhen nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik dhe DRKK Gjirokastrë sondazhe për të përfitur informacion mbi shtresat kulturore; të dokumentohen gjetjet arkeologjike rastësore në fshatin Dukaj-Tepelenë dhe raporti i tyre të paraqitet në KKA e rradhës. Ky informacion mund të shërbejë për iniciimin e një projekti të ardhshëm kërkimor shkencor.
- II. Të informohet Pushteti Lokal në lidhje me gjetjet arkeologjike rastësore in Situ në fshatin Dukaj-Tepelenë, i cili të bashkëpunojë me DRKK Gjirokastrë me qëllim ruajtje e kësaj zone me potencial arkeologjik, deri në qartësimin e një propozimi për shpalljen e saj "Zonë e mbrojtur".
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO